



AKK-ja mbajti Kuvendin e Punës

Në këtë Kuvend përveç delegatëve merrnin pjesë edhe kryetarët e komunave dhe përfaqësuesit e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

KRYETARËT E KOMUNAVE kërkojnë zgjidhjen e problemeve në menaxhimin e pronës si dhe në menaxhimin e ndërmarrjeve publike

Në një kërkesë nga Dr. Bajram Rexhepi, Kryetar i AKK-së lidhur me problemet të cilat Komunitat e Republikës së Kosovës ballafaqohen me menaxhimin e pronës si dhe menaxhimin e Ndërmarrjeve Publike drejtuar z. Sadri Ferati, Ministër i MAPL-së, z. Ahmet Shala, Ministër i MEF-it dhe z. Shkumbin Bicaj, z/Drejtor i AKP-së ndër të tjera thuhet:

Në takimin e fundit të Këshillit të Kryetarëve të Republikës së Kosovës, në të cilën ishin prezent edhe z. Shkumbin Bicaj nga AKP-ja dhe z. Ramadan Sejdiu nga MEF-i është diskutuar për problemet të cilat Komunitat e Republikës së Kosovës ballafaqohen me menaxhimin e pronës si dhe menaxhimin e Ndërmarrjeve Publike.

Si rezultat i diskutimeve të shumta, nga ky takim kanë dalur rekomandimet dhe kërkesat e Kryetarëve të Komunave drejtuar MAPL-së, MEF-it si dhe AKP-së. Kërkesat/Rekomandimet janë të mëposhtëshënuara.

KËRKESAT

1. Agjensioni i Kosovës për Privatizim (AKP) të filloj vizitat nëpër komuna dhe të marr shënime për brengat dhe pengesat që kanë ato në lidhje me procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.

2. Qeveria të sponsoroj amendamentimin e ligjit duke synuar që:

a) komunat gjithnjë të konsultohen para marrjes së vendimit për privatizim dhe që vendimi të jetë në harmoni të plotë me interesat e përgjithme të Komunitat

b) komunat të kenë mundësi të shpronësojnë pronën publike me koston më të ultë të mundshme dhe në mënyrat më të thjeshta të gjitha pronat që janë nën menaxhimin e AKP-së, e që janë me interes publik.

3. Komunitat të kenë të drejtë të shpallin zona me interes të veçantë dhe kjo e drejtë të njihet nga AKP-ja.

4. Procedurat për shpronësim të jenë të shpejta në raste të veçanta, sikurse që mund të jenë ofertat për investime nga partnerë ndërkombëtar.

7. Nëse procesi i privatizimit do të vazhdojë me politika të tilla, atëherë komunat e Republikës së Kosovës do të mbesin pa pronë komunale dhe kjo situatë do t'i sjellë komunat e Kosovës para një akti të kryer dhe kjo do të ndikojë drejtpërdrejtë në Zhvillimin Ekonomik Lokal.

REKOMANDIME

1. Menaxhimi i mbeturinave duhet të bëhet nga komuna. Kjo e rrit efikasitetin si dhe lidhjen qytetar-komunë-kompani.

2. Ndërmarrjet për ujë dhe kanalizim duhet të menaxhohen nga kompanitë regjionale, por në ato raste kur është e mundshme dhe nuk ndikohen komunat tjera, këto kompani të menaxhohen nga komunat.

3. Politikat Menaxheriale ndaj Deponive Sanitare duhet të ndryshohen Mbesim me shpresë që kjo kërkesë do të shqyrtohet nga ana Juaj dhe që përgjigja do jetë pozitive.

Me nderime

Dr. Bajram Rexhepi - Kryetar i AKK-së

PËRGJIGJET E MINISTRISË SË EKONOMISË DHE FINANCAVE:

Në vijim gjeni rekomandimet / komentet të shqyrtuara me shumë kujdesë nga MEF-i.

- REKOMANDIMI I -I-: Menaxhimi i mbeturinave duhet të bëhet nga Komuna. Kjo e rrit efikasitetin si dhe lidhjen qytetarë-komunë-kompani.

Komenti në Rekomandim: Çështjen e menaxhimit të mbeturinave e rregullon Ligji mbi Ndërmarrjet Publike, Neni 3, pika 2, ndërsa përfaqësimin e Komunave në pjesëmarrjen në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale e rregullon Udhëzimi për këtë çështje, të cilin Udhëzim iu kemi dërguar të gjithë Kryetarëve të Komunave.

- REKOMANDIMI I -II-: Ndërmarrjet për Uji dhe Kanalizim duhet të menaxhohen nga kompanitë regjionale, por në ato raste kur është e mundshme dhe nuk ndikohet nga komunat tjera, këto kom-

pani të menaxhohen nga komunat.

Komenti në Rekomandim: Menaxhimin e Kompanive të Ujësjellësve Regjional e Rregullon po ashtu LNP Neni 3, pika 1 dhe lista dy faqe 32 që d.m.th se ato janë Ndërmarrje Publike Qendrore. Ndërsa në raste ku ka kërkesa që të Menaxhohen drejtpërdrejt nga Komuna këtë e rregullon Neni 3, pika 3 ku decidivisht thuhet se për themelimin e NP është e autorizuar vetëm Qeveria.

- REKOMANDIMI I -III-: Politikat Menaxheriale ndaj Deponive Sanitare duhet të ndryshohen.

Komenti në Rekomandim: Struktura Organizative dhe Menaxheriale e Deponive është si vijon: Një deponi Qendrore si NP Qendrore (KLMC), e menaxhuar nga Pushteti qendror përmes Bordit të drejtorëve dhe gjashtë NP regjionale për mbeturina si NP Lokale e të menaxhuara nga pushteti lokal

përmes përfaqësuesve të Komunave në Bordet e drejtorëve.

Ky organizim nuk është edhe aq i suksesshëm për disa arsye:

1. Inkasimi jo i mjaftueshëm i shërbimeve nga ana e KRM dhe moskryerja e obligimeve të KRM ndaj KMLC, dhe kjo e fundit nuk ka mundësi që t'i kryen obligimet kontraktuale ndaj operatorëve.

2. Menaxhimi jo i mirë i Kompanisë qendrore për menaxhimin e mbeturinave etj.

Duke pasur parasysh të gjitha këto Komisioni i Ministrave për NP ka autorizuar që në KLMC të kryhet një incizim (auditim) i gjendjes aktuale nga zyrtarët profesional, dhe pas shqyrtimit të raportit mbi KLMC do të pasojnë hapat e mëtejme lidhur me këtë kompani.

U mbajt Kuvendi i Punës së AKK-së

Prishtinë, 27 shkurt 2009 - Asociacioni i Komunave të Kosovës me 27 shkurt 2009 mbajti Kuvendin e vetë të Punës. Në këtë Kuvend përveç delegatëve merrnin pjesë edhe kryetarët e komunave dhe përfaqësuesit e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë (Ministri i MAPL-së z.Sadri Ferati, Ambasadori i OSBE-së z.Werner Almhofer, Përfaqësuesja e USAID-it znj.Susan Fritz, përfaqësuesja e SDC znj. Sylvia Schae-rhahn, përfaqësuesi i GTZ-së z. Michael Nebelung, Përfaqësuesi i UNDP-së z.Krenar Loshi). Fjala hyrëse e paraqiti kryetari i AKK-së Dr.Bajram Rexhepi ndërsa fjalë përshëndetëse mbajtën z. Sadri Ferati, Ministër i MAPL-së, znj. Susan Fritz Përfaqësuese e misionit të USAID-it për Kosovë, z. Eerner Almhofer, Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë, z. Krenar Loshi, Përfaqësuesi i UNDP-së për

Kosovë, znj. Sylvia Schae-rhahn, në emër të SDC për Kosovë, z. Michael Nebelung, Kryesuesi i GTZ-së për Kosovë. Poashtu kryetari i AKK-së Dr.Bajram Rexhepi paraqiti para të pranishmëve Raportin Vjetor të Punës dhe atë Financiar për vitin 2008 ndërsa aktivitetet dhe projektet e ardhshme të AKK-së i paraqiti z. Sazan Ibrahim - Drejtor Ekzekutiv i AKK-së. Po ashtu Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim

paraqiti para Kuvendit një raport të shkurtër lidhur me punën e 10 kolegjiemeve profesionale të AKK-së gjatë vitit 2008. Pas diskutimeve edhe nga ana e delegatëve në fund, me shumicë votash u miratua raporti i Punës dhe Raporti Financiar për vitin 2008 nga ana e delegatëve të Kuvendit të AKK-së, ndërsa vërejtjet e thëna në Kuvend do adresohen më tutje. Në fund Kuvendin e AKK-së e përshëndeti edhe z. Slobodan

dan Vujicic nga Shoqata e Malazezëve të Kosovës i cili tha se kjo ftesë dhe kjo pjesëmarrje tregon se kemi filluar një etapë të re në bashkëpunimin me komunitetet që jetojnë së bashku. Kjo është edhe e një rëndësie tjetër meqë jam këtu me kryetarët e komunave dhe zyrtarët tjerë komuna e të cilët janë shumë afër shqetësimeve të qytetarëve.



Në prani të kryetarëve të Komunave u nënshkrua Udhëzimi Administrativ për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi

Në vazhden e takimeve të përbashkëta të bashkëpunimit, mes Asociacionit të Komunave të Kosovës me institucionet qendrore u organizua takim me kryetarëve të Komunave të Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Policinë e Kosovës. Në këtë takim morën pjesë kryetarët e Komunave, z.Zenun Pajaziti Ministër i Punëve të Brendshme, z.Shpend Terdevaj - Zv/Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal. Dhe përfaqësuesit të strukturave të Policisë së Kosovës dhe Komandantët Rajonal të Policisë së Kosovës. Ministria

e Punëve të Brendshme para kryetarëve të komunave ka prezantuar një Udhëzim Administrativ që ka të bëjë me themelimin e këshillave komunale për siguri në bashkësi, ndërsa qëllimi i themelimit të tyre është identifikimi dhe adresimi i çështjeve mbi krimin, sigurinë dhe kualitetin jetësor. Ministri i Punëve të Brendshme, Z.Zenun Pajaziti tha se krijimi i këtij mekanizmi ka për qëllim edhe ndërtimin e besimit ndërmjet policisë, autoriteteve komunale dhe komuniteteve lokale. Ai shtoi se kjo ka të bëjë edhe me ndërtimin e një partneriteti dhe iniciativave të përbashkëta për zgjedhjen e

problemeve të sigurisë në këto bashkësi. "Unë inkurajoj dhe ju ofroj mbështetjen e MPB-së për funksionalizimin e këtij mekanizmi shumë të rëndësishëm, i cili do të instalojë një koncept të ri të sigurisë që quhet siguria humane", tha Pajaziti. Ministri Pajaziti më tej nënvizoi se ky koncept vendos sigurinë e individit, grupit të caktuar apo komunitetit në qendër të vëmendjes. Sipas ministrit Pajaziti, ky udhëzim është një koncept të cilin institucionet komunale dhe qendrore duhet ta aplikojnë urgjentisht. Ky udhëzim administrativ i cili u nënshkrua nga ministri i MPB-së dhe zëvendësministri i

Pushtetit Lokal, Shpend Terdevaj, është bazuar në Ligjin për policinë dhe atë për Pushtetin Lokal, i cili do të mundësojë praktikisht që ideja për themelimin e këtyre mekanizmave të bëhet tani në përputhje me ligjin. Në këtë takim folën edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shëmet Ahmeti dhe Kryetari i Asociacionit të Komunave z. Bajram Rexhepi, përfaqësuesi i Qeverisë Amerikane ndërsa nga Kryesuesi i departamentit për çështje të Komunitetit, Kolonel Fahredin Verbovci u paraqit tema siguria në Komunitet.

Vërejtjet dhe sugjerimet e disa komunave lidhur me PROJEKT LIGJIN PËR TRAJTIMET E NDËRTIMEVE PA LEJE

KOMUNA E PRISHTINËS

Mendojmë se, në nenin 2 përkufizimet, duhet t'i shtohen edhe këto:

- Ndërtimet e përkohshme (neni 2 i Ligjit për ndërtimin nr. 2004/15);
- shtëpitë për pushim (vikend),
- Zhvillimi i punimeve ndërtimore pa leje

Neni 12 i shtohen pika 6 dhe 7:

Deklarata personale e parashtruesit të kërkesës për legalizim, që merr për sipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqë natyrore dhe/ose nga përdorimi i objektit ndërtimor. Sipas këtij ligji , shteti nuk është përgjigjes për kompensimin ose dëmshpërblimin në rast fatkeqësish, si pasojë e faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit. Deklarata e parashtruesit të kërkesës për legalizim, ku pranohet zbatimi i planit rregullues, përfshi respektimin e hapësirave publike, gjelbërimin, tipin e rrethimit, ngjyrat, ndriçimin, parkingun etj.

Neni 14 i shtohen pikat (4,5,6,7 dhe 8)

është ndërtuar në tokë bujqësore të kategorisë I-IV; është ndërtuar në sipërfaqe ku bëhet eksploatimi i xeheve apo është e rezervuar për këtë qëllim; është ndërtuar në afërsi të burimeve ujore të kategorisë I-II; është ndërtuar në objekte dhe stabilimente komunale; është ndërtuar në zonat e rezervuara për sport - stazat të skijimit.

Neni 15

paragrafi 1 i këtij neni të reduktohet ose të hiqet i tëri sepse dënim (100%) është i lartë dhe destimulues për realizimin e këtij procesi;

Neni 24 i shtohet edhe paragrafi 3)

3) Objektet që do të legalizohen, duhet të evidentohen në operatin kadastral në çdo komunë në të cilin përket objekti, në pajtim me dispozitat ligjore.

Komuna e Prizrenit

Te neni 2 - te përkufizimet ku figuron sipërfaqja e përgjithshme 450 m² me etazhitet P+2, duhet shtohen edhe fjalët varësisht se ku ndodhet objekti përkatësisht në cilën pjesë të qytetit ndodhet nga se gjendja në teren atë ku nuk ka Plan rregullues Urban duhet të jetë dis-

tanca e objektit gjer në 3 m. prej vijës rregulluese edhe asaj ndërtimore si dhe katshmëria duhet të jetë më e ulët dhe sipërfaqja e objektit duhet të jetë më e vogël.

Në nenin 19 duhet të shlyhen fjalët ankesë - e në vend sajë duhet të jetë padi, nga se pala zhvillon kontest administrativ me padi në Gjykatën Supreme të Kosovës, e jo me ankesë.

Në nenin 20 në vend të fjalës Vendim duhet të qëndrojë Aktvendim nga se organi i shkallës së parë merr aktvendim edhe atë konform neneve 82, 84 të LPA-së nr. 02/L-28.

Në dispozitat e parafundit mungojnë procedurat e rregullta të kontrollit teknik si dhe të procedurës për dhënien e lejes së përdorimit nga se për tu bërë kontrolli teknik organi kompetent formon komisionin për pranimin teknik të sajë, kurse për dhënien e lejes së përdorimit e njëjti komision jep vlerësimi a mund të përdorohet apo jo si objekti i tillë. Andaj në kuadër të sajë duhet të shtohet nenet e posaçme si për kontrollin teknik edhe gjithashtu për lejen e përdorimit.

KOMUNA E VUSHTRRIËS

Në këtë projekt Ligj mungojnë sqarimet për trajtimin e objekteve të cilat hiqen nga regjistri .

Si dhe trajtimi i objekteve të cilat fare nuk kanë hyrë në regjistër.

Neni 7 paragrafit 2 pas fjalës procedurat ti shtohet fjala për legalizim .

KOMUNA E NOVOBËRDËS

Neni 1, pika 3 . Me qëllim të ndërmarrjes së duhet bërë formulim ndryshe : Ndërmarrja e veprimeve

Neni 2 te definicioni "Projekti i sanimit ndërtimor " fjala shtesat të zëvendësohet me fjalën "anekset "

Neni 2 te definicioni "Shtëpi familjare" fjala ndihmëse të zëvendësohet me fjalën " anekse"

Neni 3 paragrafi 4 -Duhet bërë precizim se kujt i referohet kjo dispozitë Planit

Rregullativ Urban apo Planit Komunal për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje

Neni 3 paragrafi 5 pas fjalës Plan Zhvillimor i Komunës duhet të shtohet edhe " Plani rregullues Urban"

Neni 7 duhet të bëhet një formulim ma preciz lidhur me afatin e Organeve tjera (30) ditë; A ka të bëjë më afatin prej (30) ditësh pas Miratimit të Planit Komunal ? apo (30) ditë pas afatit prej (90) ditësh që është përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni

Neni 9 paragrafi 1 pas pjesën në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ti shtohet fjalia : nga dita e publikimit të njoftimit për aplikim për legalizim

Neni 11 paragrafi 2 në fund duhet ti shtohet fjalia në bazë të kriterëve të përcaktuar me Programin e Komunës dhe Rregulloret përkatëse komunale

Neni 12 paragrafi 2 : pjesa personi kompetent duhet të zëvendësohet me „Organi kompetent“

Neni 12 paragrafi 5 duhet të bëhet precizimi se për çfarë dëshmie të detyrimeve financiare të investitorit bëhet fjalë

KOMUNA E MAMUSHËS

Neni 2.

-Te definicioni "Organet tjera " të përdoret definicioni " Ministria përgjegjëse"

Neni 3

-Dispozita 5, Pas fjalisë " Plani Zhvillimor i Komunës të lidhet edhe fjala Plani Urbanistik

Neni 9

Paragrafi 1 pas fjalisë " në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të vazhdohet me fjalia " pas shpalljes publike (konkursit)"

Neni 13

Në titull nenit fjala " për legalizim "nderohet me " për legalizimin"

Neni 20

Në titullin fjala " legalizim " të nderohet me fjalën " legalizim"

Neni 21

Në titullin e nenit fjala " Inspektimi " të nderohet me fjale " Verifikim".

Takim pune i Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor me MAPL-në dhe OSBE-në

Të enjten më datë 26.03.2009 në Hotel "Victory" në Prishtinë u mbajt një takim pune i përbashkët në mes të Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor të Komunave me përfaqësuesit e MAPL-së dhe të OSBE-së. Takimi u organizua nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe MAPL-ja në bashkëpunim me OSBE-në. Qëllimi i këtij takimi ishte të diskutohet për tema si teknikat unike të hartimit të akteve komunale, zbatimi i legjislacionit primar dhe sekondar në komuna, identifikimi i nevojave për trajnim nga fusha e legjislacionit, etj. Në hapje të takimit, Drejtori i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal z.Agron Maxhuni i njoftoi të pranishmit lidhur me punën që po bëhet në përgatitjen e një Doracaku lidhur me teknikat unike të hartimit të akteve komunale. Ai tha se nevoja për një doracak të tillë ka qenë e kamotshme dhe e domosdoshme, ngase deri më tani ka ekzistuar një laramani e madhe në hartimin e akteve të ndryshme komunale, duke mos ju përmbajtur një teknikë unike të hartimit të këtyre akteve dhe duke u thirrur shpesh here në legjislacion inekzistent. Ai tha se hartimi i këtij doracaku do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Kolegjiumin e Zyrtarëve Ligjor në komuna dhe do të

jetë udhëzuesi praktik se si duhet të hartohen akte të ndryshme komunale duke u bazuar në një teknikë unike të hartimit të tyre. Sipas, z. Maxhuni niveli qendror i pushtetit në Kosovë disponon më një udhëzues të tillë lidhur me teknikat e hartimit të legjislacionit dhe akteve të ndryshme dhe ky udhëzues është shndërruar më pas edhe në udhëzim administrativ. Përmbajtjen fillestare të këtij doracaku e prezantoi, z. Besim Myrtezani - Udhëheqës i Divizionit për Zbatimin e Ligjit në MAPL i cili tha se doracaku është në fazën fillestare të hartimit dhe më këtë rast ai i ftoj zyrtarët ligjor të komunave që të dërgojnë idetë e tyre lidhur me përmbajtjen e këtij doracaku. Në anën tjetër, kryesuesi i Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor në Komuna, z. Agim Salihu tha se ideja për hartimin e një doracaku të tillë është shumë e mirëseardhur dhe ai tha se zyrtarët ligjor komunal do të dërgojnë idetë e tyre lidhur me këtë doracak. Edhe zyrtarët ligjor nga komunat e tjera e mirëpritën idenë për hartimin e këtij doracaku dhe thanë se kjo do të ndihmojë komunat në hartimin e duhur të akteve të ndryshme komunale duke respektuar një teknikë unike në hartimin e tyre dhe duke eliminuar gabimet e ndryshme në

këtë drejtim. Ata poashtu kërkuan që në këtë doracak të futet edhe një rekomandim më të cilin të kërkohet nga strukturat e ndryshme komunale që gjatë hartimit të akteve komunale dhe nënligjore të konsultohen zyrtar ligjorë në komuna, apo zyrtarët ligjor. Në vazhdim të këtij takimi, z. Maxhuni bëri edhe një prezantim të raportit mbi zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar në komuna nga fushëveprimi i MAPL-së. Në këtë kontekst ai përmendi një sërë sfida me të cilat po përballen komunat në zbatimin e këtyre ligjeve. Ai përfundoi një sërë rregulloresh komunale dhe akteve tjera nënligjore në të cilat komunat i kanë zbatuar në mënyrë të pjesërishme, si: Miratimi i Statutit të Komunës, Miratimi i rregullores për transparencë komunale, Miratimi i Rregullores për bashkëpunim me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, etj. Në këtë drejtim u kërkua nga komuna që të kenë një rol më aktiv në miratimin sa më të shpejtë të këtyre akteve nënligjore në komuna, si dhe të këtë një zbatim më të mirë të tyre në nivel komune. Në fund të takimit u fol rreth nevojave për trajnim të zyrtarëve ligjor komunal prej të cilëve u kërkua që të identifikojnë fushat në të cilat ata kanë nevojë për trajnime. Lidhur

me këtë çështje folën përfaqësuesit e OSBE-së, z. Bilbil Kastrati, z. Arben Fetahu dhe znj. Ida Manton të cilët shprehën gatishmërinë e OSBE-së që të ofroj ndihmë në trajnime për zyrtarët ligjor në komuna. Ata thanë se OSBE disponon me kapacitete njerëzore dhe financiare për të ndihmuar kolegjiumin e zyrtarëve ligjor komunal në organizimin e trajnimeve të ndryshme të cilat do të mbahen sipas nevojave të identifikuar nga vetë zyrtarët ligjor në komuna. Ata thënë se formati i trajnimeve nuk do të jetë si deri më tani në formën klasike, por ato do të konceptohen në një mënyrë tjetër ku do të punohet në fokus grupe të cilat do të dalin me rezultate konkrete nga këto trajnime. Zyrtarët Ligjor të Komunave mirëpritën këtë iniciativë për trajnime dhe metodologjinë e këtyre trajnimeve për të cilën thanë se është e adekuate. Ata identifikuan disa fusha në të cilat do të nevojiteshin trajnimet, si: Teknikat e hartimit të akteve komunale; Bibliotekat juridike në komuna; Arkivimi i lëndëve; Procedurat administrative, etj. Poashtu u vendos që zyrtarët ligjor në afat kohor prej një jave të dërgojnë idetë dhe nevojat e tyre lidhur me këto trajnime.

Me ndihmën e AKK-së ndërpritet greva e punëtorëve të shëndetësisë

Prishtinë, 5 mars - Pas takimeve të shumta e maratone me në fund të gjitha palët bien dakord që të ndërpritet greva e punëtorëve të shëndetësisë. Kjo u arrit pas një takimi që ka pasur kryeministri Hashim Thaçi me

Asociacionin e Komunave të Kosovës, ku u arrit marrëveshja që shumën prej 44 eurosh punëtorëve të shëndetësisë t'ua paguajnë komunat e Kosovës. Kjo pagesë nga buxhetet komunale do të bëhet vetëm për

nivelin primar të shëndetësisë. 18 kryetarët e komunave të Kosovës kanë shpreh gatishmërinë që prej të mërkurës nga buxheti i tyre të bëjnë pagesat prej 44 eurove për të gjithë punëtorët e qendrave të mjekësisë familjare

nëpër Kosovë. Ndërkohë që do të fillojë të punohet edhe për pagesën e stazhit të punës, e cila ishte një nga pikat e marrëveshjes.

USAID/IKE në bashkëpunim me AKK-në dhe MAPL-në ndau 520 mijë dollarë për 15 komuna të Republikës së Kosovës

USAID/IKE në bashkëpunim me AKK-në dhe MAPL-në ndau 18 donacione për pesëmbëdhjetë komuna të Republikës së Kosovës, në vlerë prej 520 mijë dollarëve amerikanë, si pjesë e Nismës për "Komuna Efektive", në mbështetje të procesit të reformimit të qeverisjes lokale në Kosovë. Ky projekt për ndihmë komunave u realizua në bashkëpunim të USAID/IKE me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe MAPL-në. Shefja e misionit të USAID-it në Kosovës, Patricia Rader inkurajoi udhëheqësit komunal që edhe në të ardhmen do ta kenë mbështetjen e USAID-it. "Jam e impresionuar me idetë e juaja dhe jam e kënaqur me

punën tuaj që keni bërë për të përmirësuar jetën e qytetarëve tuaj. Dhe ju inkurajoj që edhe në të ardhmen idetë e juaja do të shqyrtohen me kujdes", ka theksuar znj. Rader. Në takim morën pjesë edhe z. Sadri Ferati - Ministër i MAPL-së, z. Ahmet Shala - Ministër i MEF-it dhe z. Sazan Ibrahim - Drejtor Ekzekutiv i AKK-së. Komunitet të cilat kanë qenë përfituese e këtyre shpërblimeve janë: Gjakova, Vushtrria, Dragashi, Gjiçani, Drenasi, Klina, Lipjani, Podujeva, Shtimja dhe Skenderaj. Këto shpërblime u dhanë për katër kategoritë vijuese:

- Përdorimi i teknikave të menaxhimit inovativ (dy shpërblime me nga USD 20,000)

- Përpjekjet për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve (tetë shpërblime me nga USD 15,000)

- Rritja e të hyrave vetanake (pesë shpërblime me nga USD 45,000), dhe

- Implementimi i legjislacionit të ri për qeverinë lokale (3 shpërblime me nga USD 45,000).

Projektet në dy kategoritë e para janë zgjedhur nga komisioni vlerësues i përbërë prej përfaqësuesëve të Minsitrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe IKE-s. Grantet për këto projekte ishin gjithsej USD 160,000 me kontribut komunal prej USD 210,845. Grantet në kategorinë e tretë

(të hyrat vetanake) u janë dhënë pesë komunave të cilat më së shumti i kanë rritur të hyrat vetanake. (rritja në përqindje) në vitet 2007 dhe 2008. Shpërblimet për kategorinë e katërt janë bazuar në pyetjen nëse komunat i kanë implementuar dispozitat e legjislacionit të ri për vetëqeverisje lokale. Ato është dashur t'i dëshmojnë komisionit vlerësues se i kishin implementuar 25 dispozitat e zgjedhura dhe kryesore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale që kanë të bëjnë me kuvendet komunale, ekzekutivin (kryetarët) dhe demokracinë e drejtpërdrejtë.

Takimi nismëtar i Agjencisë për Demokraci Lokale në Kosovë dhe Takimi i Këshillit Drejtues të Projektit për Fuqizimin e të Rinjve në Kosovë

Prishtinë, 10 Mars 2009 - Takimi është organizuar nga Asociacioni i Agjencive për Demokraci Lokale dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Takimi ka përfaqësuar ngjarje nisëse në procesin e ri-nisjes së ADL në Kosovë. Qëllimi i takimit ka qenë në njërin anë fokusimi në planifikimin e aktiviteteve të mbetura brenda projektit për Fuqizimin e Rinisë në Kosovë dhe në anën tjetër diskutimi i hapave të ardhshëm drejt hapjes së ADL-së në Kosovë, përfshirë gjetjen e partnerëve për ADL, duke përcaktuar qytetet mikpritëse (selitë) dhe organizimi i hapave të parë në procesin e ri-nisjes. Në takim kanë qenë të pranishëm hisenikët më të mëdhenj në fushën e partnerëve potencial në projektin e Rinisë dhe ADL-ve të reja: Asociacioni i Komunave të Kosovës, Këshilli i Evropës, Zyra Civile Ndërkombëtare, "Trentino con il Kosovo", "Don Bosco Centre" dhe "Community Building Mitrovica" duke për-



faqësuar "IKV Paxchristi". Përkitazi me Projektin për Fuqizimin e të Rinjve në Kosovë, është arritur marrëveshje së pari dhe më së shumti me AKK-në, "Trentino con il Kosovo", "Don Bosco Centre" dhe CBM për bashkimin e energjive në projekt se bashku me partnerët e ADL-së së vjetër në Gjiçan. Në këtë drejtim takimet e para do të organizohen para Qershorit 2009.

Përkitazi me aktivitetet drejt ri-nisjes së ADL-së në Kosovë është arritur një marrëveshje që të mbahet fokusi në aktivitetet e të rinjve duke

pasur në mendje situatën demografike dhe ekonomike në Kosovë por edhe të zgjerohen aktivitetet drejt objektivave tjera të ADL Kosovë, e që është të mblidhen së bashku autoritetet lokale dhe organizatat e shoqërisë civile duke ofruar në këtë mënyrë ndihmën e nevojshme që të sigurohet një kalim i mirë dhe stabil drejt demokracisë dhe integritimit evropian me theks mbi promovimin e marrëdhënieve tolerante dhe të bazuara në mirëbesim brenda bashkësive lokale. Duke pasur parasysh natyrën shumë-etnike të Kosovës, një nga

qëllimet e ADL-së do të jetë puna drejt fuqizimit të bashkëpunimit në mes të bashkësive dhe ndihmën drejt integritimit të tyre social dhe ekonomik - duke përfshirë punën me të gjitha bashkësitë dhe enklavat në Kosovë. Pjesëmarrësit e takimit e kanë mirëpritur këtë ide dhe ALDA dhe AKK janë të përkushtuara që të shpejtojnë procesin e zbatimit.

Përkitazi me hapat e ardhshëm në procesin e ri-nisjes, është arritur në pajtim që misioni në Kosovë dhe takimet në mes të komunave të Pejës dhe Prizrenit, ALDA, AKK-së dhe hisenikët tjerë në proces siç janë "Trentino con il Kosovo" do të mbahen qysh në Prill 2009. ALDA tashmë ka nisur procesin e gjetjes së një partneri për këtë ADL të re për rezultate pozitive. Deri në Qershor të këtij viti, të gjithë partnerët potencial të ADL-së do të identifikohen me një qëllim të realizueshëm që të ri-niset zyrtarisht ADL-ja e caktuar për Shtator 2009.

AKK-ja përkrah fillimin e procesit të bartjes së kompetencave tek komunat e Kosovës

AKK-ja ka lëshuar një deklaratë lidhur me fillimin e procesit të bartjes së kompetencave tek komunat e Kosovës në të cilën thuhet:

Siç dihet me një ceremoni solemne me rastin e nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit nga MAPL-ja, MPMS-ja, MEF-i dhe Kryetarët e Komunave, filloi bartja e kompetencave në komunat e Republikës së Kosovës në fushën e shërbimeve sociale dhe asistencës sociale.

Asociacioni i Komunave të Kosovës mirëpret nisjen e procesit të bartjes së kompetencave nga qeveria qendrore tek Komunat e Republikës së Kosovës.

AKK-ja vlerëson se bartja e kompetencave në fushën e shërbimeve sociale dhe asistencës sociale, konform

legjislacionit në fuqi shënon vetëm hapin e parë në fillimin e implementimit të procesit të decentralizimit. Kjo është edhe më domethënëse kur dihet se ky transferim i kompetencave nuk ka të bëjë me elementin etnik siç është keqkuptuar ky proces se ka vetëm këtë synim dhe se kjo fushë është mjaft e ndjeshme për jetën e përditshme të qytetarëve të komunave tona.

Edhe për AKK-në ky transferim i kompetencave ka një domethënie të veçantë drejt fuqizimit të qeverisjes lokale në Kosovë duke i shndërruar komunat në akterë kryesorë të menaxhimit të shërbimeve për qytetarët e që është në një vijë me kërkesat e vazhdueshme të AKK-së në këto 4-5 vitet e fundit.

Vlen të ceket se me kalimin

e këtyre kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe për ta administruar skemën e ndihmës sociale sipas përgjegjësisë së deleguar si dhe do të jenë përgjegjëse për hartimin e infrastrukturës juridike që rregullojnë ofrimin e shërbimeve sociale e familjare dhe planeve strategjike për zhvillimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Asociacioni i Komunave të Kosovës për fushën e shërbimeve sociale dhe asistencës sociale ka kërkuar këtë transferim të kompetencave para katër viteve, pra më 2005 kur ka vlerësuar se askush më mirë nuk i njeht situatën në fushën e asistencës sociale sesa Komunat dhe udhëheqësit e tyre.

Si për fushat tjera ashtu edhe për shërbimet sociale dhe asistencës sociale AKK-ja pra në vitin 2005 ka dalë me Deklaratat Parimore ku ka përshkruar hollësisht situatën dhe ka nxjerrë udhëzuesit për implementim të transferimit të kompetencave tek autoritete lokale.

Edhe duke qenë pjesë e Grupit Ndërmintor për Decentralizim por edhe në forumet dhe me instrumentet tjerë, AKK-ja kërkon dhe mbështet idenë që sa më shpejtë të filloi bartja e kompetencave tek komunat e Kosovës edhe në fushat tjera të qeverisjes lokale. Sepse vetëm në këtë mënyrë ne kemi shërbime më të mira për qytetarët, shërbime me efikasitet dhe një përgjegjësi të saktë në raportin qytetarë-institucione.

Dr. Bajram Rexhepi
Kryetar i AKK-së

Bordi i AKK-së u takua me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale

Me 13 shkurt 2009 u mbajt takimi i Bordit të AKK-së dhe Kryesuesve të KK-ve me ç'rast u diskutua lidhur me tema të ndryshme që kanë të bëjnë me punën e legjislativitet në pushtetin lokal. Qëllimi i këtij takimi ishte që të diskutohet lidhur me temat, si funksionalizimi i Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale si dhe Kushtetutës së Kosovës si dhe përgatitjet për krenimin e Një Vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Po ashtu një ndër qëllimet e këtij takimi ishte edhe themelimi i Kolegjiumit të Kryesuesve të KK-ve si dhe zgjedhja e kryesisë së këtij kolegjiumi. Takimin e hapi, kryetari i AKK-së, z. Bajram Rexhepi i cili pasi përshëndeti të pranishmit tha se e çmon lartë



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asociacija Kosovskih Opština

organizimin e këtij takimi, ngase nevoja për një takim të tillë ka qenë e domosdoshme duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacionin vendor dhe implikimet e tij në punën e pushtetit lokal. Prandaj tha ai ky është një rast i mirë që të trajtohen shumë tema që nuk kanë të bëjnë vetëm me legjislacionin, por edhe për

temat si pozita e kryesuesve të KK-ve, roli i ekzekutivit dhe legjislativitetit si dhe koordinimi më i mirë i këtyre dy niveleve. Më pas ai tha se qëllimi i këtij takimi të përbashkët është edhe gjetja e një mënyrë sa më të mirë të përfaqësimit të Kryesuesve të KK-ve në Asociacionin e Komunave të Kosovës duke shqyrtuar mundësinë e themelimit të Kolegjiumit të Kryesuesve të KK-ve. Ky kolegjium do të ishte një mundësi e mirë dhe do të shërbente si një forum i cili do të ishte në shërbim të kryesuesve të KK-ve të cilat do të kishin me të lehtë artikullimin dhe përfaqësimin e interesave edhe të pjesës së legjislativitetit.

Në vazhdim të takimit pati diskutime mjaft aktive nga

ana e kryesuesve të KK-ve të cilët në përgjithësi paraqitën shqetësimet e tyre lidhur me pozitën e kryesuesve të KK-ve, ku kërkuar që të këtë qartësim të pozitës së kryesuesit të Kuvendit Komunal. Ata po ashtu kërkuar që shqyrtohet mundësia që kryesuesi i KK-së të futet në listën e pagave dhe jo të paguhet më mëditje dhe forma të tjera të kompensimit. Po ashtu një ndër kërkesat e kryesuesve të KK-ve ishte edhe nevoja për një ndarje të qartë në mes legjislativitetit dhe ekzekutivit në komuna, ngase sipas tyre këto dy segmente duhet të funksionojnë si të pavarura. Ndër çështje tjera të ngritura nga ana e kryesuesve të KK-ve ishte edhe mungesa e linjës buxhetore për kuvendin komunal prandaj ata - ➔

Takim i AKK-së lidhur me mundësinë e organizimit të kooperativave bujqësore komunale

Prishtinë, 22 janar 2008 - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me organizatën Gjermane AGRAR - CON organizoi takimin një ditor rreth mundësisë së organizimit të kooperativave bujqësore komunale dhe me mundësi të zhvillimit të Shoqatës së Kooperativave të Kosovës. Prezantimin e konceptit mbi kooperativat bujqësore në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti, e bëri z. Joachim Hall, Drejtor i AGRAR-CON nga Gjermania ndërsa prezantimin e programit industrial të kompanisë gjermane CLIVENT, z. Eerner Jatsch si dhe z. Roland Eichkorn foli rreth prezantimit të konceptit mbi lidhjen e kooperativave / komunave në një rrjet lokal.

AGRAR - CON ka përvojë të madhe në organizimin e kooperativave dhe në bazë të kësaj eksperience në mendojmë që do të jetë më se e mirëseardhur që një organizim i tillë të fillojë të ndërtohet në komunat e Republikës së Kosovës. Kooperativat janë një bashkëpunim i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm i bujqve kosovarë, me qëllim të ngritjes së



rentabilitetit të prodhimit të bujqësore, krijimit të vendeve të reja të punës si dhe rrënjëzimit të një ekonomie të mesme bujqësore. Kooperativat bujqësore janë ndërmarrje të përbashkët të bujqve të pavarur, të cilat, në bazë të statutit të miratuar nga anëtarët e tyre, obligim të vetëm e kanë përkrahjen e bujqve. Ky është qëllimi i vetëm i kooperativës bujqësore.

Duke hapur këtë takim, kryetari i AKK-së z. Bajram Rexhepi ndër të tjera tha: "shpreh kënaqësinë time që Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me CLIVENT-in ka marrë iniciativën për mundësinë e themelimit të Kooperativave Bujqësore Komunale. Jemi shumë të

vetëdijshëm që Bujqësia është njëra ndër sferat kryesore që mundëson zhvillimin e Republikës së Kosovës.

Kosova është shumë e pasur me toka bujqësore dhe gjithashtu shpreh bindjen time që Kosova është edhe më e pasur me bujq të cilët janë shumë të përkushtuar në punën e vet. Qëllimi i takimit të sotëm është mundësia e themelimit të Kooperativave Bujqësore Komunale dhe më pastaj edhe mundësia e themelimit të Shoqatës së këtyre Kooperativave.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e CLIVENT, ne do të mundohemi t'i sjellim përvojat e mira nga Gjermania rreth funksionimit të Kooperativave Bujqësore atje si dhe mundësitë e për-

fitimit nga kjo përvojë. Duhet të theksoj që përafërsisht çdo i katërti person në Gjermani është anëtar i ndonjë kooperative. Shpresoj shumë që komunat e Republikës së Kosovës do të përkrahin një iniciativë të tillë dhe shpreh bindjen time të thellë që ne do të përfitojmë shumë nga funksionalizimi i kooperativave të tilla.

Themelimi i kooperativave bujqësore është i paraparë edhe me Ligjin mbi Kooperativat Bujqësore ku thuhet që Kooperativa Bujqësore është një entitet ligjor i krijuar nga personat fizik apo Juridik të cilët duhet të jenë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e vet private në kapitalin aksionar. Kooperativat ofrojnë shërbime për anëtarët e saj dhe nuk bazohet në krijimin e fitimit për vete".

Prezantimin e konceptit mbi kooperativat bujqësore në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti, e bëri z. Joachim Hall, Drejtor i AGRAR-CON ndërsa prezantimin e programit industrial të kompanisë CLIVENT, z. Werner Jatsch si dhe z. Roland Eichkorn foli rreth prezantimit të konceptit mbi lidhjen e kooperativave / komunave në një rrjet lokal.

kërkuar që KK-ve t'i lejohet që të kenë një linjë të veçantë buxhetore. Një nga kërkesat e kryesuesve të KK-ve ishte edhe nevoja e takimeve të rregullta me zyrtarët ligjor në MAPL të cilët do të ndihmonin në sqarimin e legjislacionit përkatës që kë të bëjë më komunat. Më pas, fjalën e morën edhe anëtarët e Bordit të AKK-së, z. Naim Ismajli dhe, z. Bajrush Xhemajli të cilët e përkrahën organizimin e këtij takimi

mi të cilin e konsideruansi një mundësi të mirë për të bërë sqarime të nevojshme lidhur me rolin ekzekutiv dhe legjislativ në komuna, përkatësisht rolin e kryesuesit të KK-së dhe kryetarit të komunës.

Lidhur me këtë, ata thanë se kryetarët e komunave në bazë të votave të marra nga qytetarët në zgjedhjet e drejtpërdrejta janë konfirmuar si autoritet më i lartë i komunës, por duke respektuar gjithnjë legjisla-

tin. Prandaj duke marrë parasysh këtë fakt, ata thanë se në këtë drejtim gjithçka është e qartë.

Po ashtu ata mbështeten idenë e formimit të kolegji-umit të kryesuesve të KK-ve në kuadër të AKK-së ku ata do të kenë mundësi për të përfaqësuar interesat e veta dhe t'i adresojnë ato në nivelet përkatëse.

Në fund të takimit në mënyrë unanime u vendos për themelimin e Kolegji-umit të Kryesuesve

të Kuvendeve Komunale, si dhe u bë zgjedhja e kryesisë së këtij kolegji-umi.

Kryesues i kolegji-umit, u zgjodh: z. Njazi Kryeziu nga KK Prizren.

ndërsa ZëvendësKryesues: z. Ruzhdi Jashari nga KK Shtime.

Anëtarët e kryesisë së Kolegji-umit u zgjodhën: Bajram Morina - KK Kamenicë, Ali Sylqja - KK Pejë, Ferit Idrizi - KK Vushtrri.

Komisioni Evropian ndan 6.6 milion euro për zhvillimin ekonomik rajonal në Kosovë

Komunat si Prishtina, Mitrovica, Peja, Prizreni dhe Gjlani, si rajone, do të përfitojnë deri në 500 mijë euro nëpërmjet projekteve që do t'i përgatisin për zhvillimin ekonomik.

Pesë agjencitë rajonale për zhvillim në Kosovë Prishtina, Mitrovica, Peja, Prizreni dhe Gjlani) do të përfitojnë deri në 500 mijë nëpërmjet projekteve për zhvillim ekonomik që ato pritet t'i përgatisin. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet Zyrës Ndërlidhëse Evropiane në

Kosovë (ZNKE), që për këtë qëllim ka ndarë një grand prej 2.5 milionësh, në kuadër të një fondi total prej 6.6 milionë eurosh për shfrytëzim në vitin 2009 për të mbështetur qasjen e zhvillimit ekonomik rajonal. Afati i aplikimit për këto projekte do të jetë deri në qershor të këtij viti, ndërsa prioritet do t'i jep krijimit të një ambienti konkurrues rajonal, krijimit të vendeve të reja për punë, aftësive punuese, agrikulturës dhe atyre në infrastrukturë. "Tash po hyjmë në

një fazë të re në procesin e zhvillimit ekonomik rajonal në Kosovë. Tash po mendohe mi të funksionalizojmë, të forcojmë dhe të konsolidojmë këtë proces dhe agjencitë, me qëllim që ato të bëhen një instrument dhe mekanizëm për lehtësimin dhe forcimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës, integritimit evropian si dhe pajtimit etnik", ka thënë shefi i operacioneve ZNKE, z.Kjarrtan Bjornsson. "Ne dëshirojmë që të kemi projekte konkrete dhe të prekshme",

është shprehur ai. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, z.Bajram Rexhepi, dhe kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës e ka vlerësuar si shumë të rëndësishme funksionimin e këtyre agjencive në procesin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. "Ne si përfaqësues dhe pronarë vendorë duhet të sigurojmë se bizneset dhe qytetarët tonë përfitojnë prej tyre. Krijimi i vendeve të punës, zhvillimi dhe pajtimi janë pa dyshim në krye të listës sonë të prioriteteve",

Filloi projekti i AKK-së për implementimin e Udhëzimit Administrativ 08/2009 mbi themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi

Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim dhe me financim të East West Management Institute filluan me projektin për përkrahjen e komunave mbi themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Të premten më datë 03.04.2009 në Restorant "Vila Gërmia" në Prishtinë u mbajt një takim i përbashkët në mes të Kryetarëve të Komunave, përkatësisht Këshillit të Kryetarëve të AKK-së me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe MAPL-në.

Qëllimi i këtij takimi ishte fillimi i përgatitjeve lidhur me implementimin e Udhëzimit Administrativ 08/2009 të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme i cili ka të bëjë me themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB). Ky ishte takimi i parë në kuadër të projektit i cili do të implementohet nga AKK dhe i cili ka për qëllim që t'i ndihmoj komunat në themelimin dhe funksionalizimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi. Në këtë

takim morën pjesë, kryetare e komunave të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Xhelili nga Ministria e Punëve të Brendshme, z. Shkodran Manaj, Zyrtar Ligjor në Departamentin Ligjor të po kësaj ministrie, z. Besnik Osmani, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të USAID, EWMI-së, AKK-së, OJQ-ve, etj.

Në hapje të këtij takimi, Kryetari i AKK-së, z. Bajram Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit foli për rëndësinë e themelimin të Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB). Në këtë kontekst ai tha Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi janë shumë të rëndësishme për demokracinë lokale në përgjithësi, mekanizma të tillë kanë shumë shtete të botës, prej atyre me demokraci të konsoliduara e deri te ato që janë duke kaluar nëpër procese të tranzicioneve, dhe këto mekanizma janë treguar shumë efektive. Më tutje ai shtoi së për fat të mire, niveli i krimit në Kosovë, në

krahasim me shtetet që kanë kaluar nëpër tranzicione të ngjashme nuk është aq i madh. Por, në anën tjetër ne po ballafaqohemi me dukuri të reja të krimit, që nuk kanë ekzistuar më parë në vendin tonë e që në mënyrë të drejtpërdrejtë ka ndikim te qytetarët tanë, në bashkësitë ku ata jetojnë. Për shembull, dukuria e trafikimit, abuzimit të substancave narkotike nga rinia dhe përdorimi i saj nëpër shkolla, dhuna në shkolla fillore dhe të mesme, vjedhjet e automjeteve dhe pronës së qytetarit tonë - janë çështje që i përkasin edhe komunës. Prandaj ne, strukturat komunale, shoqëria civile që është aktive në komunat tona dhe stacionet e policisë nëpër komunat tona mund dhe duhet ta shtojmë bashkëpunimin tonë që aty ku mundemi, ti zgjedhim problemet e sigurisë me qëllim të krijimit të një ambienti ku qytetarët të ndihen se jeta e tyre, e familjeve të tyre dhe pasuria e tyre është e mbrojtur, jo vetëm me ligj,

por edhe me struktura efikase që e ndihmojnë implementimin e këtyre ligjeve.

Në fund ai tha se, AKK-ja ka qenë partner i barabartë me Institucionet e Republikës së Kosovës në hartimin e Udhëzimit Administrativ 08/2009 që ka të bëjë me rifunksionalizimin e këtyre Këshillave dhe në këtë kontekst, AKK-ja ka kërkuar që anëtarët e KKSB-ve, pra për ata që nuk marrin paga nga Buxheti i Kosovës, në të ardhmen duhet të paguhen për pjesëmarrjen e tyre në këto këshilla, prandaj në besojmë që kërkesa jonë do të merret parasysh dhe si e tillë do të realizohet gjatë rishqyrtimit të Buxhetit të Kosovës në periudhën vijuese.

Në vazhdim të takimit, Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, z.Famir Xhelili duke folur për Udhëzimin Administrativ 08/2009 përgëzoi organizatorët për këtë takim dhe për projektin i cili do të ndihmoj komunat në krijimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi.

është shprehur ai. Si z.Bjornsson ashtu edhe z.Rexhepi kanë shprehur shpresën e tyre se në këtë proces do të marrin pjesë edhe përfaqësues të komunitetit serb në Kosovë dhe se nuk do të politizohet kjo çështje.

"Zhvillimi ekonomik social, krijimi i vendeve të punës është një kërkesë për gjithsecilin dhe mendoj se ekzistojnë shembuj kur komunitetet gjejnë fusha të përbashkëta dhe arsye për bashkëpunim dhe në besojmë se ky do të jetë një forum ku gjithë secili do të jetë në gjendje të shohë se kjo nuk është politik", ka thënë Bjornsson. Ndërkohë



Arkiv: Këshilli i Kryetarëve

edhe Rexhepi ka thënë që pret se komuniteti serb do të lirohet nga paragjykimet dhe do të japë kontributin e vet në këtë drejtim.

"Kjo më tepër do të vlejë për Mitrovicën, ku është shprehur një mosgatishmëri

bashkëpunim, megjithatë dyert janë të hapura në momentin që ata janë të gatshëm. Ne do të mundohemi që agjencitë rajonale të mos politizohen dhe të mos ketë besojmë se ky do të jetë një forum ku gjithë secili do të

jetë në gjendje të shohë se kjo nuk është politik", ka thënë Bjornsson. Ndërkohë edhe Rexhepi ka thënë që pret se komuniteti serb do të lirohet nga paragjykimet dhe do të japë kontributin e vet në këtë drejtim. "Kjo më tepër do të vlejë për Mitrovicën, ku është shprehur një mosgatishmëri bashkëpunim, megjithatë dyert janë të hapura në momentin që ata janë të gatshëm. Ne do të mundohemi që agjencitë rajonale të mos politizohen dhe të mos ketë politikë, sidomos ndëretnike, por me të vërtetë të jenë me qëllim zhvillimi", ka thënë Rexhepi.

Ai tha se themelimi dhe funksionalizimi i këtyre këshillave do të jetë shumë i mirëseardhur si për komunat ashtu për nivelin qendror, e në veçanti për qytetarët. Ai shtoj se këto këshilla do të jenë një mekanizëm i rëndësishëm që do ta shtojnë nivelin e bashkëpunimit në mes strukturave të ndryshme që merren me ofrimin e sigurisë për qytetarët, pra do të krijohen ura lidhëse në aspektin multisektorial si në nivelin lokal ashtu edhe më atë qendror.

Ne, si Ministri e Punëve të Brendshme do të mundohemi më të gjitha mënyrat që të ndihmojmë komunat në funksionalizimin e këtyre këshillave, prandaj ne i inkurajojmë komunat që gjatë themelimit të këtyre këshillave ta respektojnë parimin e përfaqësimit të komuniteteve pakicë, si dhe gjinisë femërore në këto këshilla.

Funksionalizimi i këtyre këshillave për siguri në bashkësi do të jenë një mundësi e mirë për qytetarët të cilët do të mund të shprehin shqetësimet e tyre lidhur me aspekte të ndryshme të sigurisë të cilat i preokupojnë ata dhe në këtë mënyrë përmes komunës, përkatë-

sisht kryetarit të komunës i cili do t'i kryesoj këto këshilla do të mund të adresohen drejt shqetësimit e qytetarëve që kanë të bëjnë me sigurinë publike, duke bërë kështu që të shtohet niveli i përgjithshëm i sigurisë në bashkësi.

Fillimin e implementimit të Udhëzimit Administrativ 08/2009 mbi themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi e përshëndeti edhe Sekretari i Përhershëm i MAPL-së, z. Besnik Osmani i cili përgëzoi AKK-në dhe EWMI-në për projektin e filluar lidhur me këtë çështje. Në vazhdim ai tha se roli i këtyre këshillave do të jetë shumë i madh për sigurinë në bashkësi dhe kjo mund të shihet mesë miri më përbërjen e tyre e cila do të jetë shumë përfshirëse duke përfshirë akterët më të rëndësishëm në nivelin lokal, si strukturat komunale, strukturat e sigurisë, bashkësitë fetare, shoqërinë civile, etj. Prandaj këto funksionalizimi i këtyre këshillave do të ndikoj jo vetëm në rritjen e nivelit të sigurisë dhe parandalimin e dukurive të ndryshme negative në bashkësi, por do të ndikoj edhe në pjesëmarrjen dhe aktivizimin e qytetarëve në

përgjithësi. Poashtu këto mekanizma janë një mundësi e mirë për afirmimin e rolit të komuniteteve pakicë dhe barazisë gjinore në Pushtetin lokal.

Në fund, z. Osmani tha se MAPL-ja do të jetë përkrahës i madh i komunave në këtë drejtim duke ofruar edhe mjete financiare për projektet që lidhën me sigurinë në bashkësi.

Takimin dhe fillimin e këtij projekti e përshëndeti edhe përfaqësuesi i USAID-it në Kosovë, z. Peter Duffy i cili vlerësoj lartë fillimin e implementimit të Udhëzimit Administrativ 08/2009 mbi themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi. Funksionimi i këtyre këshillave është treguar shumë efektive në shumë vende të Botës, prandaj ky do të jetë një rast i mirë që edhe në komunat e Kosovës të krijohen mekanizma të tilla të cilët do ndikojnë në parandalimin e dukurive negative në komunitet të cilat janë prezente në çdo shoqëri.

Në vazhdim të takimit u bë prezantimi i përmbajtjes së Udhëzimit Administrativ 08/2009 nga, z. Shkodran Manaj i cili prezantoi në detaje këtë udhëzim.

Ndërkaq, znj. Argjentina Grazhdani prezantoi udhëzimet lidhur me procedurat dhe ftesat për nominime për anëtarët e Këshillave Komunale në Bashkësi.

Në fund të këtij takimi pati diskutime mjaft aktive nga ana e pjesëmarrësve lidhur me Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Në këtë kontekst ata mirëpritën themelimin e këtyre këshillave, por edhe shprehën shqetësimet e tyre lidhur me aspekte të ndryshme të Udhëzimit Administrativ dhe për funksionimin e këtyre këshillave. Si shqetësim nga ana e disa kryetarëve të komunave u përmend mos kompensimi për anëtarët e këshillave e cila sipas tyre mund të ndikoj në mospjesëmarrjen aktive të anëtarëve të këshillit. Poashtu kishte vërejtje edhe në afatin që iu është dhënë komunave për të dërguar nominimit për anëtarë të këtyre këshillave, si dhe përfaqësimi i komuniteteve pakicë në këto këshilla. Në këtë drejtim ata kërkuar ndihmën e organizatave ndërkombëtare për pjesëmarrjen e të gjithë komuniteteve në këto këshilla.

TAKIMET E KOLEGJIUMEVE TË AKK-së

KOLEGJIUMI I DREJTORËVE TË KOMUNAL PËR PLANIFIKIM URBAN DHE KADASTËR

Të premten, me datën 13 Mars, 2009 u mbajt takimi i radhës i Kolegjiut të Drejtorëve Komunal për Planifikim urban dhe Kadastër. Takimi u mbajt në Restorant "VILLA GËRMIA" në Prishtinë. Në takim morën pjesë Drejtorë Komunal për Planifikim Urban dhe Kadastër, përfaqësuesit e të USAID/EMI si dhe ata nga Administrata e AKK-së.

Qëllimi i takimit

Qëllimi i këtij takimi ishte paraqitja e prezantimeve të ndryshme të përgatitura për këtë takim. Prezantimi i parë ishte ai i, znj. Florina Jerliu mbi pjesëmarrjen e AKK-së në Konferencën e NALAS-it, prezantimi tjetër ishte i përgatitur nga EMI/USAID dhe nga HABITAT-i. Poashtu një nga qëllimet e këtij takimi ishte edhe diskutimi rreth përgatitjes për vizitën studimore të Kolegjiut e cila planifikohet të mbahet në Shqipëri.

KOLEGJIUMI I DREJTORËVE KOMUNAL PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Të premten, me datën 13 Mars, 2009 u mbajt takimi i radhës i Kolegjiut të Drejtorëve të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ky takim u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Takimi u mbajt në Hotel "AFA" në Prishtinë. Në takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale dhe përfaqësuesit e këtyre dy ministrive.

Qëllimi i takimit

AKK-ja në bashkë-punim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale organizuan një takim pune me Drejtorë të Drejtorive Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale për një informim më të gjerë rreth procesit të transferimit të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal në lëminë e çështjeve sociale. Me konkretisht një informim rreth marrëveshjes së mirëkuptimit për bartje të kompetencave, planifikimi i buxhetit për vitin 2010, ngritjen e shqetësimeve nga zyrtarët e komunave për këtë proces etj.



TAKIMI I KOLEGJIUMIT TË DREJTORËVE KOMUNAL PËR SHËRBIME PUBLIKE

Të martën me datën 16 mars 2009 u mbajt takimi i Kolegjiut të Drejtorëve të Drejtorive Komunale për Shërbime Publike. Ky takim u mbajt në kuadër të takimeve të rregullta të këtij Kolegjiut. Në takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive Komunale për Shërbime Publike, ekspertët që kanë punuar në Deklaratën Parimore për Shërbime Publike (Ofrimi i shërbimeve të ujit, ujërave të zeza, mbeturinave të ngurta, eficientësisë së energjisë dhe transportit publik), përfaqësues të GTZ-së, dhe ata nga Administrata e AKK-së.

Qëllimi i takimit

Qëllimi i këtij takimi ishte të diskutohet dhe rishikohet detajisht lidhur me përmbajtjen e Deklaratës Parimore për Shërbime Publike dhe miratimin e saj përfundimtar, meqë shqyrtimi i saj ishte bërë edhe në mbledhjen e kaluar. Nga takimi i kaluar anëtarët e këtij Kolegjiut kishin marrë obligime që ta rilexojnë këtë Deklaratë në mënyrë që në këtë takim edhe në prani të ekspertëve që kanë përgatitur këtë dokument të bëjnë ndryshimet e nevojshme dhe ta japin versionin përfundimtar.

TAKIMET E KOLEGJIUMEVE TË AKK-së

KOLEGJIUMI I KRYESUESVE TË KUVENDEVE KOMUNALE

Më datën 17 Mars, 2009 u mbajt takimi i dytë për këtë vit i Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve Komunale. Takimi u organizua në bashkëpunim dhe në përkrahje financiare të EMI/USAID dhe u mbajt në Restorantin "VILA GËRMIA" në Prishtinë. Në takim ishin të pranishëm: Kryesuesit e Kuvendeve Komunale, përfaqësues të EMI/USAID, OSBE-së, ICO-së dhe përfaqësues të mediave dhe ata të administratës së AKK-së.

Qëllimi i takimit

Një ndër qëllimet e këtij takimi ishte që të diskutohet lidhur me pozitën e shërbyesve civil në raport me Kuvendin Komunal, përkatësisht për pozitat e dyfish-ta të cilat mbahen nga ana e shërbyesve civil (Shërbyes civil + Anëtarë i Kuvendit Komunal). Më qëllim që të dilet më ndonjë rekomandim lidhur me zgjidhjen e kësaj çështje. Poashtu qëllimi i këtij takimi ishte të diskutohet edhe lidhur me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së 2009/01 Mbi Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjeggjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Një ndër qëllimet tjera të këtij takimi ishte që të diskutohet edhe për draft planin e punës dhe rregulloren e punës për Kolegjiut të Kryesuesve të KK-ve për vitin 2009.

KOLEGJIUMI I DREJTORËVE KOMUNAL PER ARSIM DHË KULTURË

Me datën 20 Mars, 2009 u mbajt takimi i radhës i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë. Takimi u organizua nga AKK në bashkëpunim me OSBE dhe u mbajt në Restorant "KATANA" në Kastriot. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Drejtor të Drejtorive Komunale për Arsim dhe Kulturë, si dhe përfaqësues të administratës së AKK-së. Në këtë takim edhe pse ishte i ftuar nuk ishte i pranishëm Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z. Enver Hoxhaj.

Qëllimi i takimit

Një ndër qëllimet kryesore të këtij takimi ishte që të diskutohet rreth ndryshimit të Ligjit për Arsim fillor dhe të Mesëm, krijimin e mekanizmave të vlerësimit dhe monitorimit, diskutime rreth planit të punës së Kolegjiut, diskutim rreth freebalansit, etj.

TAKIMI I KOLEGJIUMIT TË ZYRTARËVE PËR INTEGRIME EVROPIANE

Më datën 18 mars, 2009 u mbajt takimi i Kolegjiut të zyrtarëve për Integritime Evropiane. Takimi u mbështet nga WYG Internacional, dhe u mbajt në sallën e asamblesë Komunale në Komunën e Prishtinës. Në këtë takim ishin të pranishëm Kryetari i Komunës së Prishtinës Prof.dr.Isa Mustafa, përfaqësues të Agjencionit Kosovar për Integritime Evropiane, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, WYG Internacional si dhe përfaqësues nga administrata e AKK-së.

Qëllimi i takimit

Njëri ndër qëllimet e këtij takimi ishte rishikimi i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) dhe procesi i monitorimit dhe raportimit të PVPE-së nga ana e komunave dhe bashkërendimi i aktiviteteve me MAPL-në. Njëra ndër synimet e këtij takimi të Kolegjiut të Zyrtarëve Komunal për Integritime Evropiane ishte edhe inkorporimi i matricës në planin e punës së komunave.

KOLEGJIUMI I DREJTORËVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

Të premtën, me datën 20 Mars, 2009 u mbajt takimi i radhës i Kolegjiut të Drejtorëve të Administratës Komunale. Ky takim u organizua në bashkëpunim dhe më mbështetje financiare EMI/USAID. Takimi u mbajt në Hotel "VICTORY" në Prishtinë. Në takim morën pjesë Drejtorë të Administratës Komunale, përfaqësuesit e të USAID/EMI si dhe ata nga Administrata e AKK-së.

Qëllimi i takimit

Njëri ndër qëllimet kryesore të këtij takimi ishte shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores së punës së Kolegjiut, si dhe Planit të Punës për vitin 2009. Hartimi i këtyre dokumenteve të punës së kolegjiut është bërë më përkrahje të EMI/USAID dhe nga puna e kryesive të Kolegjiut. Poashtu qëllimi i këtij takimi ishte që të diskutohet lidhur me gjendjen aktuale në administratën komunale në përgjithësi si dhe për shqetësimet e komunave në këtë drejtim.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti VI, Nr. 36 • Janar - Mars 2009

E PËRGATITËN:

Arsim Osmani dhe Mexhit Shaqiri

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON dhe është në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR).

